

MOTI

sot

17 — 22 °C

nesër

17 — 22 °C

sipas BBC

free press / qytetëse

# agon

Qershor

# 24



Website: [www.gazeta-agon.com](http://www.gazeta-agon.com)

E-mail: [redaksia@gazeta-agon.com](mailto:redaksia@gazeta-agon.com), [reklama@gazeta-agon.com](mailto:reklama@gazeta-agon.com)

EKONOMI

### Euro pritet të bjerë deri në 122 lekë



Forcimi i lekut kundrejt valutave, vërejtur gjatë ditëve të fundit në tregun tonë të këmbimit, pritet të vazhdojë. Ekspertët e ekonomisë parashikojnë sërish rritje të monedhës kombëtare, e shkaktuar kjo nga fluksi i turistëve dhe këtimi në atdhe i emigrantëve për pushime. Euro pritet të bjerë deri në 122 lekë...

faqe 5

BOTA

### Rusia mbështet sigurinë për Europën



Rusia, ditën e martë, mbështeti propozimin e saj për një plan të ri sigurie në Europë dhe tha se kjo nuk kishte për qëllim të ulte influencën e aleancës SHBA-NATO në kontinent, por përkundrazi, për të ulur ndarjet politike. Shtetet e Bashkuara dhe NATO reagonun...

faqe 10

LAJMI I DITËS

### Sa depresivë janë personat që na përfaqësojnë



Vitet e fundit, në vendin tonë dhe më gjerë vihen re shenja në rritje të agresivitetit të qytetarët. Ende nuk është dhënë një përgjigje e plotë, se cilat janë shkaqet kryesore në rritjen e agresivitetit dhe në shumë raste kalimi në depresion dhe gjendje të stresuar të shumë personave...

faqe 6

INSTITUTI NDËRKOMBËTAR I STUDIMEVE BALLKANIKE

# Partia Socialiste të shpëtojë sa të mundet



faqe 3



Xhuzi dhe Xhozi (Këngëtarja italiane, Giuzu Ferreri dhe Kryetarja e Parlamentit, Jozefina Topalli)

Letërsia shqipe dhe përkthimi i saj në gjuhë angleze, për herë të parë zënë vend në faqet e revistës "Translation Review" ("Kritika e Përkthimit"). E cilësuar si revista më e madhe në botë për përkthimin nga gjuhët e tjera në anglisht, "Kritika e përkthimit" botohet prej 30 vjetësh nga Universiteti i Teksasit në Dallas të SHBA-së. Numri i 76-të i kësaj reviste, që publikohet dy herë në vit, i është kushtuar tërësisht letërsisë shqipe dhe përcjelljes së saj në botën anglishtfolëse, vështirësive të përkthimit etj. Kështu, në kopertinën e revistës në vijim të kësaj ideje është vendosur një vepër e piktorit dhe skenografit shqiptar, Andis Gjoni, e titulluar "Dedalus". Në brendësi, "Kritika e Përkthimit" hapet me një shkrim të albanologut Rob-

### Kulturë/ Letërsia shqiptare në "Kritikën e Përkthimit"



ert Elsie, njëkohësisht shkrimtar dhe përkthyes. Në artikullin e tij, Elsie, një prej përkthyesve kryesorë të letërsisë shqipe në anglisht, bën një rishikim të shkurtër të letërsisë shqipe në botën anglishtfolëse, nga viti 1595, kur dhe u përkthye vepra e parë në këtë gjuhë "Historia e Skëndërbeut" e Marin Barletit, deri në ditët e sotme. Kështu ai ndalet në përkthimin e "Këngëve të Kreshnikëve", "Lahuta e Malësisë", "Bagëti e Bujqësi", pjesë nga vepra e Migjenit, Koliqit etj. Për t'u ndalur edhe në periudhën e socializmit me përkthimet e veprave të shkrimtarëve Ismail Kadare, Fatos Kongolli etj. Pjesë nga vepra e shumë autorë të tjerë si Elvira Dones, Kim Mehmeti, Viljet Aliçka, Lindita Arapi...

faqe 11

FAKTI I DITËS

### Pikët dhe frikët

Frok Çupi

Kur e kishte parë në tribunë kandidatin e Skraparit, kryetari i PS i hodhi një sy të keq e pastaj i lëshoi shishen e ujit në fytyrë. Kjo ndodhi para dy ditësh në Çorovodë, buzë lumit të Osumit. Kandidati, një skraparllit trim, me mbiemër luftë "Ylli", u step para panjes së lumit të rrëmbyer; lumi ishte shumë afër dhe mund t'i shkaktonte gjëmën. Faji i tij ishte i thjeshtë: Në mitingun e PS nuk kishin ardhur aq shumë njerëz sa kërkonte kryetari; as autobusët nga Tirana nuk kishin mbërritur akoma. Desha ta afroja panjen e liderëve me individin që rri poshtë tribunës. Ky nuk është as kandidat, as i fortë, as mundës. (Ka qëlluar që kandidati i Skraparit të ishte mundës, por gjithsesi i trembur nga kryetari). Individit mund të jetë i dobët, ose edhe jo i dëshirës për të luftuar. Atëherë ai largohet nga bregu i Osumit, largohet edhe nga tribuna dhe merr një rrugë. Askush nuk e di ku e çon individin rruga e largimit prej frikës; por diku e çon. Njerëzit, në përgjithësi, janë të prirur të largohen nga frika. Individët në frikë nuk dalin jashtë orbitës, por krijojnë enën komunikuese: Ata që frikësohen kalojnë në anën tjetër. Kështu po ndodh këtë javë shumë të bukur në prag të zgjedhjeve parlamentare. Të tremburit po shpëtojnë enën e anës tjetër.

C'është fenomeni i votimit përmes frikës?

Shqipëria mund të konsiderohet një shembull tipik i fenomenit. Gjatë periudhës së regjimit komunist, njerëzit votonin të gëzuar, por pasi ra regjimi thanë se kishin votuar "të frikësuar". Askush nuk mund të thotë të kundërtën, përderisa vetë individët e pranuan frikën. Pastaj votuan përmes një frikë tjetër: Në vitin 1991, me frikën se do të fitonte përsëri regjimi komunist (siç ndodhi në fakt); në vitin 1992- me frikën se mos Partia Demokratike antikomuniste fitonte si Partia Komuniste para kësaj; në vitin 1996- me frikën e dhunës dhe të policisë sekrete...

Vijon në faqen 2

# Letërsia shqiptare në "Kritikën e Përkthimit"

Ketrina Mara

**L**etërsia shqipe dhe përkthimi i saj në gjuhën angleze, për herë të parë zënë vend në faqet e revistës "Translation Review" ("Kritika e Përkthimit").

E cilësuar si revista më e madhe në botë për përkthimin nga gjuhët e tjera në anglisht, "Kritika e përkthimit" botohet prej 30 vjetësh nga Universiteti i Teksasit në Dallas të SHBA-së. Numri i 76-të i kësaj reviste, që publikohet dy herë në vit, i është kushtuar tërësisht letërsisë shqipe dhe përcjelljes së saj në botën anglishtfolëse, vështirësive të përkthimit etj. Kështu, në kopertinën e revistës në vijim të kësaj ideje është vendosur një vepër e piktorit dhe skenografit shqiptar, Andis Gjoni, e titulluar "Dedalus".

Në brendësi, "Kritika e Përkthimit" hapet me një shkrim të albanologut Robert Elsie, njëkohësisht shkrimtar dhe përkthyes. Në artikullin e tij, Elsie, një prej përkthyesve kryesorë të letërsisë shqipe në anglisht, bën një rishikim

të shkurtër të letërsisë shqipe në botën anglishtfolëse, nga viti 1995, kur dhe u përkthye vepra e parë në këtë gjuhë "Historia e Skëndërbeut" e Marin Barletit, deri në ditët e sotme. Kështu ai ndalet në përkthimin e "Këngëve të Kreshnikëve", "Lahuta e Malësisë", "Bagëti e Bujqësi", pjesë nga vepra e Migjenit, Koliqit etj. Për t'u ndalur edhe në periudhën e soc-realizmit me përkthimet e veprave të shkrimtarëve Ismail Kadare, Fatos Kongolli etj. Pjesë nga vepra e shumë autorë të tjerë si Elvira Dones, Kim Mehmeti, Ylljet Aliçka, Lindita Arapi, Egerem Basha, Fatos Lubonja, Teodor Laco, Dritëro Agolli etj janë përfshirë në një antologji. Sipas Elsie-s, me gjithë përpjekjet e bëra nga shkrimtarë, përkthyes apo botues në hapësirën shqiptare e më tej, letërsia shqiptare ende nuk është shumë e njohur në botën anglishtfolëse. Si e tillë, ajo është një terren që ka shumë për t'u zbuluar. Në 82 faqet e revistës paraqiten një sërë artikujsh rreth kësaj problematike, të përgatitura nga përkthyes të letërsisë shqipe si Gjekë Marinaj, Frederik Tërneri, Piter. R. Prifti, Pe-

ter Morgani etj. Kjo problematikë e përkthimit është parë edhe nëpërmjet syve të vetë shkrimtarëve. Kështu, Ismail Kadare në intervistën dhënë për Gjekë Marinajn, vlerëson rolin që luajnë përkthyesit në karrierën e çdo shkrimtari. Një rol i rëndësishëm së parë dhe unik për fatin e çdo shkrimtari dhe njohjen e tij në botë. Nga ana tjetër, Frederik Tërneri, i cili së bashku me Gjekë Marinajn kanë sjellë në anglisht disa prej poezive më të bukura të traditës e folklorit tonë, ndalet te meto-

Mujë Buçpapajt. Botim i Universitetit të Teksasit në Dallas, "Kritika e Përkthimit" është revista zyrtare e Shoqatës së Përkthyesve Letrare Amerikanë, organizatë prej 80 mijë anëtarësh, shumica akademikë, që paguanjë 60-80 dollarë në vit për anëtarësim. Ajo shpërndahet falas tek ata dhe në shumicën e librarive të universiteteve dhe qyteteve në Amerikë dhe Kanada. Botimi i këtij numri, lidhur me përkthimin e letërsisë shqipe në botën anglishtfolëse, është bërë i mundur

**▲ Ismail Kadare në intervistën dhënë për Gjekë Marinajn, vlerëson rolin që luajnë përkthyesit në karrierën e çdo shkrimtari. Një rol i rëndësishëm së parë dhe unik për fatin e çdo shkrimtari dhe njohjen e tij në botë.**

da që ai ka përdorur për përkthimin e poezisë popullore shqiptare. Të tjerë përkthyes të letërsisë shqipe si Ron Berisha, Peter Goltub dhe Laura Bouers kanë bërë një rishikim të veprave të Rudolf Markut, Luljeta Lleshanuku dhe

falë punës së Gjekë Marinajt, një prej poetëve më të lexuar të viteve të fundit, i cili njëkohësisht ka dhënë kontribut edhe në përkthimin në anglisht të veprave të disa autorëve shqiptarë dhe poezisë sonë popullore.



## Mozart, Bach dhe Brams në tingujt e Orkestrës së RTSH-së

**S**tina koncertore e Orkestrës simfonike të RTSH-së, vazhdon me disa nga emrat më të njohur të muzikës botërore. Veprat e Moxart, Bach dhe Brams do të vijnë në një mbrëmje koncertore më 25 qershor, nën drejtimin e dirigjentit Oleg Arapi dhe interpretimin e pianistëve Edlira Braka, Elda Aliaj si dhe Besiana Çegrani.

Solistët

Oleg Arapi lindi në qytetin Borisoglebsk të Rusisë. Në vitin 1988 mbaroi Institutin e Lartë të Arteve Tiranë, në degën Dirigjim, në klasën e pedagogut Eno Koço. Koncerti i tij i diplomës vlerësohet maksimalisht.

Punon Dirigjent i Orkestrës Simfonike të Filarmonisë të qytetit Vlorë, me të cilën realizoi me cilësi koncerte të ndryshme simfonike me krijimtari të autorëve të ndryshëm si Vivaldi, Bach, Beethoven, Brahms, Mozart, Mendelssohn, Schubert, Britten, Kreisler etj. Në 1989, fitoi çmimin e tretë si Dirigjent në Takimin Kombëtar të Orkestrave Simfonike. Në 1996, fitoi Med-



aljen e Artë në konkursin ndërkombëtar në Netanya të Izraelit me korin e grupit "Iirria" Vlorë. Më pas punoi Dirigjent Kori në Ansambelin e Këngëve dhe Valleve dhe Mjeshtër Kori pranë TOB-it, Tiranë, në vënieën e operave Norma e Belinit, La Traviata e Verdit etj. Ka dirigjuar koncerte të ndryshme në Itali, Spanjë, Rusi etj.

Edlira Braka është kurorëzuar me sukses në

konkursin EPTA me çmimin e tretë, të cilin e përmirëson në 2002 me çmimin e dytë dhe më vonë kur merr diplomën e aktivitetit me motivacionin "Për interpretimin më të mirë të sonatës klasike". Në mars 2009 ka luajtur në Moskë me shumë sukses. Është një nga talentet e brezit të ri në fushën e pianos.

Elda Aliaj, talenti i saj merr fill në vitin 2000 ku merr pjesë për herë të parë në konkursin prestigjioz të EPTA.

Besiana Çegrani gëzoi sukses të menjëhershëm, të cilin e konkretizoi në konkursin ndërkombëtar të Barletta-s Itali, ku u vlerësua me çmimin e parë. Vazhdon me trofeun e çmimit të parë në konkursin ndërkombëtar të Placenza (Validone) Itali. Në dhjetor të vitit 2000, në konkursin "Këngët e Tokës", vlerësohet me çmim special. Në 2006, në konkursin "Mozartiana" në Shkup (Maqedonia), vlerësohet me çmimin e parë. E pason në konkursin "Këngët e Tokës", ku merr çmimin special. Ka luajtur tre koncerte recitale, ndër të cilët dy në TKOB, në vitet 2008 dhe 2009 dhe tjetri në qytetin e Korçës.

## Vendet e kujtesës dhe kulturat e kujtesës

**D**eri në ç'pikë është i zbatueshëm koncepti i vendeve të kujtesës për Shqipërinë dhe vendet fqinje? Kjo pritet të diskutohet në një simpozium i cili do të organizohet nga Universiteti i Tiranës, i Mynhut dhe i Bilefeldit në nëntor 2009 në Tiranë, si një bashkëpunim me Këshillin e Gjermanistikës, me fondacionin "Alexander-von-Humboldt" dhe Ambasadën Gjermane në Tiranë. Për këtë kërkohen artikuj, të cilët paraqesin konceptin e vendeve të kujtesës me tiparet e tij themelore dhe e përpunojnë atë në kuadër të kujtesës së kulturave. Historianë, studiues të letërsisë, artistë të arteve figurative, lingvistë, hulumtues të shkencave sociale e didaktikës etj., mendohet të marrin pjesë në dialogun ndërdisiplinor mbi kuptimin dhe shëndërrimin e vendeve të kujtesës dhe kulturave, veçanërisht në rajonin e Europës Juglindore, por edhe në vende të tjera.

## "Gjallë", premiera në Austri

**Ë**shtë një nga festivalet më të rëndësishëm të filmit pas Kanës. Ndaj për regjisorin shqiptar Artan Minarolli nuk është një ngjarje pa rëndësi shfaqja e premierës së filmit të tij të ri në "Karlov Vary International Film Festival" në Çeki.

Filmi i tij "Gjallë" ende nuk ka shfaqur premierën e tij në Shqipëri, por ka vendosur që "udhëtimin" të publiku ta nisë me Çekin. Së bashku me aktorin kryesor të filmit, Kreshnik Xhelilaj, regjisor do të jetë i pranishëm gjatë shfaqjes së filmit në datën 5 korrik (për median) dhe në datën 6-7 korrik për jurinë e festivalit. Filmi, me skenar dhe regji të Minarolli, prek një temë shqiptare tepër të preshme siç është gjakmarrja, duke rrokur fort në trajtimin e tij të shkuarën, të sotmen dhe të ardhmen. Bazar në skenarin e Ylljet Aliçkës, (një bashkëpunim që duket se Minarolli e ka shumë për zemër), ngjarjet e filmit vendosen në vitin 1997, në kohën e trazirave në Shqipëri. Në qendër është Koli, djaloshi malësor, studenti i vendo-



Artan Minarolli

sur në metropolin shqiptar, por që është edhe viktima e radhës së gjakmarrjes. I kthyer papritur në Malësi, pranë familjes së tij pas lajmit për vdekjen e të atit, pikërisht në varrim ai mëson për të parën herë se është pjesë e zinxhirit të një gjakmarrjeje. Krah aktorit Nik Xhelilaj interpretojnë edhe emra të tjerë si Bruno Shllaku, Reshat Arbana, Naida Salliasi, Tinka Kurti, Xhevdet Ferri, Luljeta Bitri etj. Filmi, një bashkëpunim shqiptaro-austriakofrancez, ka mbyllur xhirimet në gusht të 2008-ës, ndërsa postproduksioni i tij është realizuar në Austri. Një pjesë e mirë e xhirimeve është realizuar në Lurë, ndërsa kanë qenë edhe rreth 60 vende të tjera xhirimi. Për publikum në Shqipëri, premiera e "Gjallë" mendohet të jetë në shtator.